

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**„ DGN SERVICES & CONSULTING“ SH.P.K**

**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI**

**Neni 1**

**Themelimi**

**Sot më 18 Prill 2024**

Themelohet Shoqëria tregtare **“DGN SERVICES & CONSULTING”** sh.p.k si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” nga ortaku I meposhtem:

- 1- **Nicola Delle Grazie** shtetësi Italiane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr.pasaporte AS7380827 lindur ne Bari (BA), Itali datë 01.08.1961 dhe banues ne Bari, Via Goito 29 Carbonara,Bari, Itali.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Kjo shoqëri fiton zotesinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, qëndër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

**Neni 2**

**FORMA DHE EMERTIMI**

2.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakeve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

2.2.Emërtimi i shoqërisë është **“DGN SERVICES & CONSULTING”** sh.p.k.

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjaltë “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k.

**NENI 3**  
**BAZA JURIDIKE**

4. Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 4**  
**SELIA**

5.Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë.

Ne adresen: Njesia Farke, Selite, Rruga Reli, Nr.1, kati 0, hyrja 2, 1060 ,Tiranë dhe mund te ndryshojë seline e saj me vendim të ortakeve.

## NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Konsulenze e firmave . ndermjetesie, konsulenze marketing e tregtare.Pjesmarrje ne shoqeri te tjera dhe blerje aksione ne shoqeri te tjera.Projektim, modelim, prodhim, implementim dhe testim software. Shitje license software dhe sherbimeve perkatese te lidhura me to. Dhenie me qira e softwareve. Software si sherbim. Sherbime te adoptimit dhe pershtatjes se softwareve. Sherbime suporti dhe mirmbajtje te teknologjise se informacionit. Sherbime te konsulences teknike ne fushen e teknologjise se informacionit dhe aktivitetet te tjera te subjekteve private dhe publike. Sherbime trajnimi dhe edukimi ne fushen e teknologjise se informacionit. Sherbime te hostimit te bazave te dhenave dhe te dhenave perkatese.

- Projektimi, prodhimi dhe tregtia në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar makinerive te perpunimit te drurit, hekurit, llamarines dhe plastikes.
  - Projektimi, prodhimi dhe tregtia brenda dhe jashte vendit te veglave elektrike dhe makinerive ne te gjithë sektoret , industriale dhe te sherbimit.
  - projektimit, prodhimit dhe tregtisë te paisjeve mekanike, elektromekanike,elektrike, elektronike dhe informatike , përfshire softwere te cdo tipi aplikimi, ne Shqiperi apo jashte vendit.
  - Pjesmarrja ne aksione , blerja dhe shitja e tyre , si ne shoqeri vendase dhe jashte territorit te Republikës se Shqiperise.
  - Menaxhimi dhe konsulenza menaxheriale dhe/ ose financiare te kompanive ne Shqiperi apo jashte vendit
  - Konsulence teknike, tregtare, administrative, financiare dhe menaxheriale në Shqipëri dhe jashtë saj
  - projektimin, ndërtimin dhe tregëtimin në Shqipëri dhe jashtë saj te asetëve të çdo lloji, dhe të kryeve importet dhe eksportet e të gjitha llojeve te produkteve, me pakicë dhe shumicë për sektorin industrial, arsimore, artizanale, ushqimit dhe bujqësisë.
  - Projektimi, ndërtimi dhe tregëtimi , ne Shqipëri dhe jashtë te paisjeve, sistemeve te destinuara për shërbime arsimore, trajnime profesionale, teknike dhe universitare në të gjitha fushat.
  - projektimin, ndërtimin, në Shqipëri dhe jashtë vendit te paisjeve per bujqësi, blegtori, peshkim si dhe tregëtimi i produkteve te tyre.
  - projektimin, ndërtimin, në tregun Shqipëtar dhe jashtë tij , te materialeve plastike të të gjitha llojeve dhe formave për çdo aplikim dhe të përdorim.
  - Projektim, ndërtim dhe tregëtim te produkteve artizanale, ne Shqipëri dhe jashte saj.
  - projektimin, prodhimin dhe tregëtimin në Shqipëri dhe jashtë vendit për prodhimet e mobilimit dhe industriale.
  - Turizem dentar , nga italia dhe vende te tjera.
  - projektimin, ndërtimin, ne tregun Shqipetar dhe jashtë saj, materiale ndërtimi përfunduar dhe të papërpunuara
  - Prodhimin dhe tregëtimin në Shqipëri dhe jashtë vendit ujë mineral në shishe, verërat, pijet dhe pije të buta
  - Blerja dhe shitja e automjeteve te markave te ndryshme dhe tonazheve te ndryshme, ne te cilat autoveture për transportin e udhëtarëve, linjat e autobusëve të pasagjerëve për turizmin kombëtar dhe linjat ndërkombëtare për transportin e mallrave, dhenia me qera e automjeteve, me kohe te shkurter dhe afatgjate.
  - Blerja dhe shitja, pajisje shtëpiake, mjekësore, elektromjekësore, te higjieno-sanitareve, mjete dhe aparatura elektronike, kompjutera dhe paisje te tyre.
- Hapja e call center shumegjuheshë
- Përfaqësimi i mallrave dhe shërbimeve te ndryshme si ne Shqiperi dhe jashte saj.
  - menaxhimi i operacioneve industriale, tregtare dhe financiare edhe tërësisht jashtë territorit kombëtar.
- Krijimi e exchange emony transfer.
- Gestione e investimentit in criptovalute. Hapja dhe mirembajtja e website.
- Krijimi dhe menaxhimi i e-commerce
- Punime per te trete, ( fason) .
- Kompania gjithashtu mund të kryejnë të gjitha transaksionet tregtare dhe financiare dhe të zbatojë të gjitha nismat që lidhen me arrijen e objektivave sociale, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që lidhen me pronën e luajshme dhe të paluajshme

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

## NENI 6 KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

**NENI 7  
TERRITORI**

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

**KAPITULLI III  
AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI**

**NENI 8  
FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT**

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

**NENI 9  
LIBRI I SHOQËRISË**

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, **Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.**

**NENI 10  
KONFIDENCIALITETI**

10.1 Ortaku i vetem shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

**NENI 11  
DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT**

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxiren nga Shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "SH.P.K", si dhe emrin e administratorit.

**NENI 12  
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRANSFERIMI I  
TYRE**

12.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë: 1.200.000,00 (njemilione e dyqind mijë) leke .

12.3 Ky kapital themeltar i shoqërisë është i zotëruar nga Ortaku i vetem si me poshte:

- 1- **Nicola Delle Grazie** shtetësi Italiane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr.pasaporte AS7380827 lindur ne Bari (BA), Itali datë 01.08.1961 dhe banues ne Bari, Via Goito 29 Carbonara,Bari, Itali. **Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1.200.000,00 (njemilione e dyqind mijë) leke e barabrte me 100% te kapitalit te shoqërisë.**

**Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinj të përcaktuara nga ligji.**

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të behët në përputhje me nenet 72- 75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

### Neni 13

#### Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

- Pjeset e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.
- Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar si trashigimni ose brenda familjes personave perfitues do të behet pasi ata të pranojnë permbajtjen e statutit të kesaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të kete pesuarderi ne momentin që keto pjese të kapitalit themeltar të behen lehtesisht të transferueshme.
- Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t transferohen personave të trete që nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të ortakut themelues, ne persona të tjere jo ortake të shoqërise do të behet vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast ortaku që kerkon të largohet nga shoqëria, duhet të respektoje të drejten e parablerjes së kuotave nga ortaket themelues të shoqërise. Ne rast se kuotat e ortakut themelues janë të tilla që kane një çmim tregu të ndryshueshem do të merret si çmim i pranuar çmimi me i larte i shitjes, çmim i konfirmuar me garanci oferte të verifikueshem nga pjesmarresit e Asamblese se shoqërise. Në rast vdekjeje të ndonje prej ortakëve të shoqërisë trashëgimtarët e tij apo rast ndarje pasurore midis bashkeshortëve, subjektet perfitues sipas ligjit kane të drejtë të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit të shoqërise ose për vazhdimin e veprimtarisë sipas parashikimeve ne ligj nepermjet trashëgimise dhe pjesmarrjes se trashëgimtareve ligjore ne shoqeri apo bashkepjesmarrjes nga ndarja e pasurise bashkeshortore. Ortaket e kesaj shoërie, mund të vendosë të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e sheh të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

### ORGANI DREJTUES ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

#### NENI 14

##### Asambleja e Ortakeve

Secili aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e mbledhjes së aksionarëve dhe mund të ketë në numër votash të barabarta me aksionet e kapitalit të zotëruar.

Një anëtar mund të përfaqësohet në një mbledhje të përgjithshme në bazë të një delegimi nga një partner tjetër, bashkëshorti ose personi tjetër i caktuar prej tij, me kusht që të autorizohet nga një prokurë.

Asambleja e ortakeve perbehet nga mbledhja e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërise. Ajo mblidhet me kerkesen e Administratorit. Gjithashtu secili prej ortakeve ka të drejtë t'i paraqese Administratorit kerkese me shkrim per mbledhjen e asamblese te pergjithshme duke treguar ne te arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Ne rast se kërkesa refuzohet, ortaku kanë të drejtë të thërrase asamblenë dhe të caktojë çështjet e rendit të ditës.

Permbajtja dhe rendi i dites iu njoftohet ortakeve te pakten 7 dite perpara mbledhjes se Asamblese, ne rastin e shoqërise njoftimi iu behet te ditur te gjithë ortakeve themelues. Mbledhja quhet e vlefshme kur me nje nga menytrat e percaktuar ne ligj, eshte bere njoftimi i ortakeve të shoqërise (pjesmarresve të themeluesve), me konfirmim shkresor duke percaktuar edhe rendin e dites se mbledhjes. Ne rast se pjesmarresit marrin pjese personalisht ata do të konsiderohen të njoftuar pavarësisht nese nuk ka konfirmim me shkrim. Pjesemarresi ne mbledhje mund të jete vete ose të perfaqesohet nga nje tjetër person të caktuar me Prokure perfaqesimi, duke patur të shprehur objektin e mbledhjes ne mbledhjen e Asamblese. Vendimet e asamblese të cilat merren me shumice të thjeshte do të jene të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Vendimet të cilat merren me shumice të kualifikuar do të jene të vlefshme vetëm nëse janë të pranishem ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave. Do të meren me shumice të kualifikuar prej ¾ të kuotave pjesmarse vendimet per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Te gjitha vendimet e tjera do të meren me shumice të thjeshte.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kësaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e përdorimit.
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

#### Neni 15

##### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaku sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

#### NENI 16

##### KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

**Asambleja e Ortakeve ka per kometence :**

- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.
- Te emeroje apo shkarkoje Administratorin e shoqërisë, pronar ose jo pronar.
  - Të jape ose jo pelqimin per caktimin e ekspertit kontabel nga Administratorët e shoqërisë, i cili do te beje auditimin e vitit ushtrimor;
  - Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj ;
  - Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj ose te kerkuar nga çdo ortak ;
  - Te jape ose jo miratimin per marrjen e çdo lloj huaje apo kredie bankare.
  - Te jape ose jo miratimin per shtimin e kapitalit apo pakesimin e tij.
  - Te vendose per miratimin ose jo te largimit te ortakut ne rast te shitjes se kuotave dhe zevendesimin e tij me nje person tjetër.
  - Kompetenca te tjera që parashikohen ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare"

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

##### NENI 17

##### ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

Kompania mund të administrohet nga administratori i vetëm ose administratorët e shumtë, të cilët mund të jenë persona fizikë të emëruar brenda komunitetit ose jashtë këtij komuniteti. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rimerimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie. Administratori të detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqesë raport të ortaku i vetëm apo të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqërisë është **Manjola Ismaili** shtetase Shqiptare, lindur në Skrapar, Shqipëri, e datëlindjes 25.05.1985 banuese në Tiranë Njazi Demi Nd 14 H 17 Ap 5 Njesia administrative Nr 5 Njesia bashkiake Nr 5 1019 TIRANE, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues karte identiteti (Identity card) nr. Personal I55525072V, me afat emërimi për 5 vjet me të drejtë rriemërimi.

## LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTET NENI 18 LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

## NENI 19 BILANCI

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.  
Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.  
Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

## NENI 20 DIVIDENTET

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe duke theksuar ekzistencën e fitimeve, mbledhja e aksionarëve përcakton pjesën e anëtarëve në formën e dividendëve mbi fitimet, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit aksioner në kompani. Fitimet që do të shpërndahen midis anëtarëve në përpjesëtim me aksionet e kapitalit të kompanisë, përbëhen nga fitimi i vitit në të cilin janë zbritur shumat e rezervuara për fondin e domosdoshëm të aksioneve (5% të fitimeve) të secilit vit, derisa ky fond arrin vlerën 1/10 të kapitalit të kompanisë) dhe, nga ana tjetër, humbjet ose të ardhurat e mbajtura nga vitet e mëparshme zbriten ose rriten respektivisht.

**NENI 21  
MBARIMI**

22.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsye të parashikuara në ligj.

**NENI 22  
LIKUJDIMI**

23.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimi që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimi dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimi, ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimi. Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

**MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT  
NENI 23  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimi do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare, pasi të jete ezauruar mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirkuptim midis ortakëve.

**NENI 24  
DISPOZITA E FUNDIT**

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësinë e së cilës do të përcaktohen nga Ortaku i shoqërisë.

Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, më 18.04.2024

**Ortaku i vetëm**

**Nicola Delle Grazie**

